



K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE "ERNISA-S" SH.P.K.

Sot me daten 19 Korrik 2001, ne Tirane, Shqiperi;
Ne mbeshtetje te ligjit nr 7638, date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregetare" ne Republikën e Shqiperise, Ligjit 8770 date 19 Prill 2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera ligjore, shtetasit;

1. VESEL PODO, i biri i Dine, i datelindjes 04.08.1960, lindur ne Berat, me pashaporte me numer QH 240275 dhe banues ne Korce, ne Rrugen "Sheshi i Bashkise", Pallati 1, A/13.

2. SADETE PODO, e bija e Hajderit, e datelindjes 25.06.1961, lindur ne Berat, me pashaporte me numer QH 240614 dhe banuese ne Korce ne Rrugen "Sheshi i Bashkise", Pallati 1, A/13.

Me cilesine e ortakeve themelues, me vullnetin e tyre te lire e te plote, vendosen te ushtrojne veprimtari private, per sa me poshte vijon;

NENI 1

Te Themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, per te ushtruar veprimtari ne perputhje me Ligjin nr. 8770 date 19.04.2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike".

NENI 2

Shoqeria do te emertohet : Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "ERNISA-S" SHPK.

NENI 3

Objekti i veprimtarise Shoqerise eshte : Kryerja e sherbimeve te kategorise (a + b);

- Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimtari ne Republikën e Shqiperise.

- Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te personave fizike, shtetas Shqiptare ose te huaj.

Shoqeria per te permbushur misionin e vet, ka te drejte te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje nderlidhje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Per ruajtjen e Objekteve, Shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke mare masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

NENI 4

Shoqeria do te kete seline ligjore ne Korce, ne adresen ; Sheshi i Bashkise, Pallati 1, A/13. Ne baze te nenit 5 te ligjit nr 8770 date 19.04.2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", Shoqeria ka te drejte te ushtroje veprimtarine ne gjithe teritorin e Republikës Shqiperise.

NENI 5

Mareveshja midis paleve per kohezgjatjen e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar mbi 10 vjet. Kontrata do te jete efektive nga dita e regjistrimit te kontrates dhe statutit ne Gjykatën e Shkalles Pare te rrethit Tirane, marjes se lejes te ushtrimit profesionit, dhe regjistrimit ne organet tatimore. Nga kjo dite shoqeria fiton zotesine per te vepruar si Person Juridik.

NENI 6

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 5.500.000 leke (pese milion e peseqindmije).

Ky kapital eshte nenshkruar dhe shlyer si me poshte;

\$- 5.225.000 (pese milion e dyqindenjetepese mije) leke, zoti VESEL PODO, baras me 95% te kapitalit shoqerise.

- 275.000 (dyqinteshtatedhjetepese mije) leke, zonja SADETE PODO, baras me 5 % te kapitalit shoqerise.

NENI 7

Administratore te Shoqerise do te jene z. VESEL PODO dhe SADETE PODO.

Drejtimi teknik dhe perfaqesimi ligjor i saj do te behet nga zoti VESEL PODO.

Palet jane te detyruar te zbatojne statutin e shoqerise, mbajne pergjegjesi per thyerjet disiplinore ose demtimin e pasurise se saj, te ruajne fshehtesine e shumave e te te ardhurave te shoqerise, depozitimeve te saj, te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informacionit, te njohurive dhe pervojës ne kuadrin e veprimtarise shoqerise.

NENI 8

Fondet monetare te shoqerise do te perdoren nga Asamblea e Ortakeve e Administratoret e saj ne perputhje me detyrat e percaktuara ne statutin e shoqerise, ne lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise dhe shtrirjen e saj nga koha ne koha. Palet themeluese kane te drejte te celin llogari likujduese me vehte ne banke, te nxjerre bilance periodike per veprimtarine ekonomiko-financiare dhe te perfitojne perqindjet e interesit, te cilat percaktohen e miratohen nga Asamblea e Ortakeve.

NENI 9

Te ardhurat nga veprimtaria private te percaktuara ne kontrate dhe ne statutin e shoqerise jane parashikuar ne nene te vecanta te statutit. Kapitali fillestar dhe kapitali i mevonshem mund te krijojne nje fond te vecante jo me pak se 5 % per tu shenuar si rezerve ligjore, mbas berjes se bilancit ekonomiko-financiar te cdo viti kalendarik.

NENI 10

Shoqeria "ERNISA" S SHPK duke qene Person Juridik i pavarur, rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me dispozitat e kesaj kontrate themeluese, te statutit dhe legjislacionit ne fuqi.

NENI 11

Mosmareveshjet zgjidhen nga Asamblea e Ortakeve dhe kur nuk eshte e mundur, nepermjet Gjykates Shkalles Pare te rrethit Tirane.

Palet themeluese dhe punonjesit e shoqerise, duhet te njihen me dokumentacionin baze te shoqerise te perbere nga kontrata dhe statuti i saj.

T H E M E L U E S I T

VESEL PODO

Vesël Podo
(Pretor)

SADETE PODO

Sadete Podo
(Pretor)



STATUTI I SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE "ERNISA - S" SH.P.K.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr 7638 date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise", Ligjit nr 7667 date 28.01.1993, Kodin Tregetar te Republikes te Shqiperise dhe ne vecanti Ligjin 8770 date 19.04.2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike" si dhe te dispozitave perkatese te kontrates per krijimin e shoqerise;

1. **Vesel Podo**, i biri i Dines, i datelindjes 1960, lindur ne Berat dhe banues ne Korce ne rrugen "Sheshi i Bashkise", Pallati 1, A/13.
 2. **SADETE PODO**, e bija e Hajderit, e datelindjes 1961, lindur ne Berat dhe banuese ne Korce ne rrugen "Sheshi i Bashkise", Pallati 1, A/13.
- Me daten 19 Korrik 2001 nxoren kete Statut.

I. DISPOZITA TE PERGJITHESHME.

NENI 1

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise te tregut te lire. Ajo eshte krijuar me kontraten per krijimin e shoqerise ne pronesi private me mjetet vetiake te ortakeve.

NENI 2

Shoqeria me kete statut, ne perputhje me kontraten per krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ERNISA - S" SHPK dhe me legjislacionin Shqiptar, rregullon poziten juridike te ortakeve dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e Shoqerise.

NENI 3

Shoqeria nga neni 1 i ketij statuti, do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "ERNISA - S" SHPK. Shoqeria ka statusin e Personit Juridik.

NENI 4

Selia e Shoqerise eshte ne Korce ne rrugen "Sheshi i Bashkise" Pallati 1, A/13. Ne baze te nenit 5, pika 2 e ligjit Nr. 8770 date 19.04.2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", Shoqeria ushtrome veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes Shqiperise.

II.OBJEKTI I SHOQERISE.

NENI 5

Shoqeria ka per Objekt te veprimtarise se saje ;

- Kryerja e Sherbimeve te kategorise (a + b);

- Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise.
- Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve shqiptare ose te huaj.

Shoqeria per te permbushur misionin e vet, ka te drejte te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje nderlidhje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Per ruajtjen e objekteve, shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

NENI 6

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj nuk mund te ndryshoje pa pelqimin e ortakeve. Ato behen vetem me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 7

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

NENI 8

Per detyrimet e veta shoqeria pergjigjet me tere pasurine e saj. Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet qe ka secili me te tretet.

NENI 9

Ortaket bartin rezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) te dhena me rastin e krijimit te saje. Rreziku qe u kanoset personave juridike e fizike me te cilat eshte lidhur kontrate sipas kategorise licences perballohet nga shoqeria dhe njihet si shpenzim.

III. MJETET E SHOQERISE

NENI 10

Mjetet ne te holla dhe mjetet e tjera per krijimin e fillimin e punes se shoqerise, ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, i sigurojne vete ortaket ne shumen e pergjitheshme 5.500.000 leke.

Pjesemarja e ortakeve ne keto pjese eshte;

1. Personi privat Vesel Podo merr pjese me 95 % me vlere nominale 5.225.000 leke (pese milion e dyqind enjzetepese mije).

2. Personi privat Sadete Podo merr pjese me 5 % me vlere nominale 275.000 leke (dyqinde shtatedhjetepese mije).

NENI 11

Pas celjes se llogarise xhiruese te shoqerise ne nje nga bankat e rrethit Korce, ortaket jane te detyruar qe mjetet e percaktuara ne nenin 10 te ketije statuti te kalojne menjehere ne kete xhiro llogari.

NENI 12

Ortaket mbajne te drejten e pronesise ne mjetet (kuotat) e percaktuara nga neni 10 i ketije statuti, te investuara per krijimin e shoqerise.
Ortaket nuk pergjigjen me pasurine e tyre vetijake per detyrimet e shoqerise.

NENI 13

Kapitali themeltar i Shoqerise se Ruajtjes dhe Sigurise Fizike mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise. Zvogelimi i Kapitalit Themeltar nen vleren 4.000.000 (kater milion) leke e detyron Shoqerine te kufizohet per te kryer aktivitet;

a) Vetem te kategorise "b" nese kapitali themeltar eshte ndermjet 3.000.000 leke (tremilion) e 4.000.000 leke (kater milion);

b) Vetem te kategorise "a" nese kapitali themeltar eshte ndermjet 2.000.000 leke (dy milion) e 3.000.000 leke (tre milion);

ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e kapitalit deri ne vleren 4.000.000 (kater milion) leke.

IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, me statutin e saj dhe me legjislacionin ne fuqi.

Bekefaj

Shaj

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga Drejtuesi Teknik i saj Z. VESEL PODO. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per Shoqerine.

NENI 15

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e investuara ne fondet e saj, me kredite e marra dhe me mjete te tjera. Shoqeria eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi nga shuma e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

NENI 16

Shoqeria percakton fondet e meposhteme; 1. Fondin themeltar. 2. Fondin rezerve.

NENI 17

Fondi themeltar i shoqerise formohet nga mjetet e investuara te ortakeve dhe nga mjetet ne para te investuara nga persona te tjere.

NENI 18

Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet, per investime ne fondet e ndermarjeve dhe organizatave te tjera qe i ka formuar ajo, si dhe per te mbuluar reziqet pas shfrytezimit te mjeteve rezerve. Fondin themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje dhe per destinime te tjera ne perputhje me aktet e politikes se saj afariste.

NENI 19

Fondi rezerve i shoqerise formohet nga ajo pjese e fitimit qe ajo realizon gjate veprimtarise se saje qe percaktohet me nje vendim te vecante. Mjetet e fondit rezerve jane mjetet vetiake te shoqerise dhe shfrytezohen per te mbuluar humbjet dhe reziqet. Fondi rezerve mund te perdoret dhe per destinacione te tjera ne perputhje me aktet e politikes afariste te shoqerise.

V. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 20

Organet Drejtuese te shoqerise jane; -Asambleja e ortakeve, si themeluese e shoqerise
-Administratori i Shoqerise.
-Drejtuesi Teknik Ligjor i shoqerise.



-5-
ASAMBLEA E ORTAKEVE

NENI 21

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise. Ajo perbehet nga dy veta, te cilet zgjidhen ne mbledhjen e asamblese.

NENI 22

Asambleja e Ortakeve ushtron keto detyra;

\$ Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit dhe akteve te pergjithshme, vendimin per ndryshimin e emertimit te selise dhe veprimtarise shoqerise.

\$ Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

\$ Jep udhezimet e nevojeshme dhe orienton punen e administratorit te shoqerise.

\$ Miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise.

\$ Vendos per ndarjen dhe perdorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve dhe reziqeve.

\$ vendos per ndryshimin e formes organizimit te shoqerise.

\$ Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise.

\$ Emeron e shkarkon administratorin.

\$ Nxjerr rregulloren per punen e asamblese se ortakeve.

\$ Drejton punet e tjera te rendesishme per afarizmin e shoqerise.

Asambleja e ortakeve punon dhe vendos ne mbledhje me shumice sipas kontributit te kapitalit.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

NENI 23

Shoqeria ka administratoret e vet te cilet jane Z. VESEL PODO dhe SADETE PODO.

NENI 24

Mandati i administratoreve te shoqerise nuk eshte i kufizuar. Ne mungese ose ne pamundesi te ushtrimit te funksioneve te administratoreve ata i zvendeson punonjesi, te cilin e caktojne vete.

NENI 25

Administratoret kane keto detyra; \$ Organizojne dhe drejtojne punen e veprimtarise se shoqerise.

\$ Perfaqesojne shoqerine ndaj personave te trete.

\$ Pergjigjen per ligjshmerine e puneve si dhe per aktivitetin ekonomik te shoqerise.

-6-

\$ Propozojne nxjerjen e akteve nga asamblea e ortakeve.

\$ Kryejne te gjitha punet ne shoqeri te cilat sipas ketij statuti nuk jane ne kopetence te asamblese se ortakeve.

\$ Lidhin kontrata qe nuk jane ne kopetence te Drejtuesit Teknik dhe kryejne pune e veprime te tjera juridike brenda autoriteteve te asamblese ortakeve.

NENI 26

Administratori i Shoqerise mund te shkarkohet;

-Me kerkesen e tije.

-Kur ortaket vertetojne se ai eshte pergjegjes per mosarritjen e rezultateve afariste te shoqerise.

-Ne rastet e tjera te parashikuara ne ligj.

VI. DREJTIMI TEKNIK

DREJTUESI TEKNIK

NENI 27

Shoqeria ka ne perberje te personelit dhe te sigurise fizike nje Drejtues teknik,i cili pajiset me lejen perkatese per ushtrimin e profesionit kur ploteson kushtet e pasashikuara ne Ligjin nr 8770 date 19.04.2001''Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike''.

NENI 28


Drejtuesi teknik eshte Drejtuesi me i larte teknik i Shoqerise dhe pergjegjes ligjor per trajtimin,bashkerendimin dhe kontrollin e sherbimit te ruajtjes dhe te sigurise fizike.Kur per shkaqe te ndryshme Drejtuesi Teknik largohet nga shoqeria,kjo eshte e detyruar te njoftoje menjehere Drejtorin e Policise Qarkut,ku ushtron veprimtarine.Ne keto raste Shoqeria brenda 45 diteve i paraqet autoritetit licensues kerkesen per zvendesimin e drejtuesit teknik si dhe pajisjen e tije me lejen perkatese,nese ai nuk ka nje te tille.

NENI 29

Drejtuesi teknik i shoqerise eshte i detyruar te njoftoje menjehere organet e Policise Shtetit per cdo ngjarje qe ndodh ne objektet qe ka ne ruajtje shoqeria dhe cdo tre muaj njofton me shkrim per kryerjen e detyrave te ruajtjes dhe te sigurise fizike,si dhe per problemet qe kane lindur.

NENI 30

Shoqeria "ERNISA" sh.p.k do te kete si DREJTUES TEKNIK,ortakun dhe administratorin e shoqerise Z. VESEL PODO.



NENI 31

Maredheniet ndermjet Shoqerise dhe personit fizik a juridik qe merret ne rruajtje rregullohen me marreveshje te perbashket,ku pjese e saje eshte dhe Rregullorja e Sherbimit dhe sipas rastit rregullorja e brendeshme e objektit.

Drejtuesi Teknik nenshkruan mareveshjet me persona te autorizuar nga personi fizik a juridike qe merret ne rruajtje.

Ne mareveshjen e nenshkruar , Rregullorja e Sherbimit eshte pjese e marreveshjes dhe hartohet sipas rregullores tip te miratuar me Urdher te Ministrit Rendit Publik.

Punonjesi i Sherbimit

NENI 32

Shoqeria ka ne perberje te personelit te rruajtjes dhe te sigurise fizike punonjes te sherbimit,te cilet pajisen me lejen perkatese per ushrimin e profesionit kur plotesojne kushtet e parashikuara ne ligjin perkates.

NENI 33

Punonjesi i sherbimit vepron me cilesine e Rojes fikse ose ne levizje,te Truprojes,te Operatorit,te shoqeruesit qenit te sherbimit,te drejtuesit te mjetit gadishmerise dhe kryen detyra te ngjashme me to si dhe permbush detyrat e rruajtjes dhe te sigurise fizike,te percaktuara ne Ligjin nr 8770 date 19.04.2001''Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike''.

Punonjesi i Sherbimit ka pergjegjesi ligjore per ruajtjen e objektit.

MENYRA DHE KUSHTET E NDARJES FITIMIT

NENI 34

Pas perballimit te detyrimeve,taksave,tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi shoqerise dhe ndarjes se mjeteve per pagat e punonjesve,shoqerise i mbetet ne dispozicion fitimi neto i cili ne perputhje me nenin 10 te ketije statuti ndahet sipas kontributit te secilit.

Secili ortak mund te perdore lirisht sipas deshires se tije pjesen e vet te fitimit.

NENI 35

Nese ortakët njehere i kane mbuluar humbjet e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) te investuara me rastin e krijimit te saje,nuk jane te detyruar te bartin rrezikun per humbje te metejshme.



-8-

NENI 36

Ne qofte se ne bilancin vjetor shoqeria nuk del me fitim por me humbje,humbjet do te mbulohen ne perputhje me nenin 10 te ketije statuti.

NENI 37

Fitimi ishoqerise ne rastin e paraqitjes se rrethanave nga neni 9 i ketije statuti,nuk do te ndahen ne perputhje me nenin 10 te ketije statuti.

NENI 38

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk do te mbulohen,mjetet e ortakeve si themelues te dhena me rastin e krijimit te shoqerise ne perputhje me nenin 9 te ketije statuti,ndaje shoqerise hapet procedura e likuidimit,e falimentimit.

VII MAREDHENIET E PUNES

Neni 39

Maredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise,legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje;

- Kushtet dhe menyra e lidhjes se maredhenieve te punes.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendet e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes,puna e nates,puna jashte kohes normale te punes,puna ne ditet e pushimit javor e te festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat.te drejtat,detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per caktimin e detyrave te punes.
- Pushimi i maredhenieve te punes.

NENI 40

Punonjesit per punen e tyre marin rrogen ne vartesi te rezultateve te arritura ne pune,ne perputhje me kontraten e punes.

Ne kontraten e punes percaktohet paga e punes,shperblimi i pageses dhe shperblime te tjera.

NENI 41

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me cilesi te punes dhe zbatimin me ndergjegje te disiplines punes.Mban pergjegjesi ligjore,administrative dhe demshperblen pasurine qe rruan e siguron.



VIII.KOHEZGJATJA E SHOQERISE DHE MBYLLJA

NENI 42

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 43

Shoqeria mbyll aktivitetin e sajë; -Ne rastet e parashikuara ne legjislacionin Shqiptar.
-Ne baze te vendimit te Asamblese Ortakeve.
-Kur te hapet procedura e likuidimit,e falimentimit.

NENI 44

Ne rastet e likuidimit te shoqerise,ortaket marrin pjese ne ndarjen e pasurise se shoqerise ne perpjestim me pjesemarjen e tyre ne pasurine e shoqerise.

NENI 45

Nese procedura e likuidimit te shoqerise perfundon me humbje,ortaket mbulojne humbjet nga kuota themeluese te dhena me rastin e krijimit shoqerise,po qe se nje gje e tille nuk eshte bere me pare,ne perputhje me nenin 38 te ketije statuti.

NENI 46

Nese ndonje humbje e mepareshme e shoqerise eshte mbuluar ne perputhje me nenin 38 te ketij statuti,do te hapet procedura e falimentimit te shoqerise.

IX.DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 47

Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "ERNISA -S " shpk eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me marjen e lejes se ushtrimit profesionit nga organi kopotent,regjistrimit te saje ne Gjykatën e Shkalles Pare te Rrethit Tirane dhe regjistrimit ne organet tatimore.

NENI 48

Ndryshimet e ketije statuti behen me te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxiret ky statut.Propozimin per ndryshimin dhe plotesimin e statutit mund ta jape secili prej ortakeve te shoqerise.Ndryshimet dhe plotesimet e statutit te shoqerise behen vetem me vendim te Asamblese Ortakeve.



-10-

NENI 49

Mosmareveshjet e shoqerise ne maredheniet me personat juridike e fizike,vendas e te huaj, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Shkalles Pare e rrethit.

NENI 50

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet Ligjit nr 7638 date 19.11.1992''Per Shoqerite Tregetare ne republiken e Shqiperise'', Ligjit nr 8770 date 19.04,2001''Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike'' dhe cdo akti tjetër te legjislacionit shqiptar.

NENI 51

Statuti perpilohet ne disa kopje per tju dorezuar organeve kopetente. Nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike ''ERNISA - S'' SHPK, Korce.

O R T A K E T

VESEL PODO

Vesël Podo
[Signature]

SADETE PODO

Sadete Podo
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE


Nr. 664 Rep.
Nr. 419 Kol.

VERTETIM

Sot me date 10 . 09 . 2001 (dymije e nje) u paraqiten personalisht para meje noteres ne Tirane, Vesel Podo dhe Sadete podo, Ortake te Shoqerise ''ERNISA - S'' shpk, Korce, me gjeneralitetet e mesiperme, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat e tyre personale, te cilet deklaruan se sa me siper eshte Statuti i Shoqerise i perpiluar me vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet rregullisht perpara meje une noterja e vertetoje sipas ligjit.

NOTERE

Fatmara Shehu



Talca
[Signature]
[Signature]
100 lre